

Ju keni deklaruar si burim të prindërve kursimet e tyre në vite, të ardhurat nga biznesi dhe trashëgimia si dhe shitblerjen e pasurive të paluajtshme.

Por Komisioni vuri në dukje se nga hetimi kishte mungesë dokumentacioni për të provuar këto të ardhura. KPK bëri me dije se nuk provoheshin të ardhurat e babait nga aktiviteti privat për rreth 1.2 milionë lekë.

Sipas Komisionit, nuk kishte asnjë dokument provues për aktivitetin tregtar të prindërve, prej të cilit supozohej se ishin kursyer 5 milionë lekë. Drejtoritë e tatimeve në Shkodër dhe në Lezhë kishin mohuar se prindërit e Vokshit ishin rregjistruar.

Pra ILDKPKI nuk iu kalon, ndonëse KPK iu dha "provimin", a mendoni se duhet të shpjegoheni se si ka mundësi financiare një prind të dhurojë shtëpi për djalin pa të ardhura si prindë?

Pyetje 2: Si ka mundësi që Ju këtë apartament e keni shitur me 17/11/2020, pothuaj 9 muaj sapo morët konfirmimin nga KPK, dhe keni blerë një tjetër partament me sip.102.88 metra katrorë deklaruar 138,000 dollarë amerikanë? Apo manovruat që sa të mbaronte Vettingu të ishit i "varfër" dhe sapo kalove "lumin" shite dhe bleve?!

Dhe ngjitur me këtë pyetje: Në cilën zonë e keni blerë dhe sa ishte çmimi i referencës nga Ministria e Financave në momentin e blerjes në nëntor 2020? A e keni blerë nga ndonjë firmë private ndërtimi që ju e keni patur në procese gjyqësore ndër vite?

Pyetje 3: Në deklaratën e vitit 2021 thoni se keni një automjet me vlerë 3,600 euro. A mund të na shpjegoni që nëse ka automjete me këtë vlerë që mund të lëvizin në Tiranë dhe nëse po mund të na jepni një foto të makinës e cila kushton kaq lirë?! A mendoni se me këtë vlerë që ju thoni, automjeti krijon probleme mjedisore, pra tym, pasi një automjet me këtë vlerë vetëm tym nxjerrë!

Pyetja 4: Gjatë punës tuaj si gjyqtar deri në shkurt 2020, ku morët konfirmimin, a keni gjykuar ndonjë çështje që lidhet direkt apo indirekt me familjarë të Suela Zhegu, Genta Tafa Bungo dhe Etleda Çiftja, të cilat ishin trupa gjyqësore në KPK? Po pas konfirmimit a keni gjykuar apo marrë pjesë në trupë gjyqësore që lidhet me këto emra?

Pyetje 5: Ju deklaroni se keni marrë shpërblime nga shkolla e Magjistraturës dhe Fakulteti i Drejtësisë në Tiranë. Dakort se mbetet një meritë e juaja, por si rregull mësimdhënia është deri në ora 16.00 dhe ju ndërkohë nga ora 09.00 deri në ora 16.30 duhet të jeni në detyrë si